



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 23.12.2014, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku- zëvendëskryetar i parë, Bojan Miliq- zëvendëskryetar i dytë, Ganimete Musliu, Anton Quni, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dhurata Kryeziu-OSBE, Luanda Domi-DCAF dhe Lumni Rama-OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Konstituimi i Komisionit

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari i përshëndeti anëtarët e Komisionit duke u prezantuar se është Daut Haradinaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe e kryeson këtë Komision.

Pasi e prezantoi përbërjen e Komisionit u uroi punë të mbarë për këtë legjislaturë. Gjithashtu theksoi se nga ana e Lëvizjes VV ende nuk është caktuar emri që do të jetë pjesë e këtij Komisioni. Duke qenë se ky takim është formal për konstituimin e Komisionit, theksoi se para vetës kemi dy përgjegjësi, siç është transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura dhe sektorin e mbikëqyrjes së Policisë së Kosovës.

Ju siguroj që do të jemi të pa anshëm, pasi Komisioni është profesional dhe nuk i nënshtrohet ndikimeve partiake. Gjithashtu kisha kërkuar nga ju që të punojmë si grup, pasi siç mund ta dini, raporti i progresit i Komisionit Evropian për Kosovën ka dhënë nota pozitive për punën e Komisionit.

Ju uroj suksese për këtë mandat dhe fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Fadil Demaku- Përshëndes anëtarët e Komisionit, gjithashtu mbështes qëndrimin e kryetarit për rëndësinë e funksionimit të Komisionit dhe raporteve profesionale në funksion të punës së Komisionit.

Në mandatin e kaluar kam qenë pjesë e Komisionit për mbikëqyrjen AKI-së, dhe mund të them që nuk është arritur sa duhet pasi shpeshherë kemi qenë të ndikuar nga vlugu i fushatave elektorale etj.

Tani kemi më shumë përvojë, dhe do të tejkalojmë partitë politike dhe do të fokusohemi në funksion të punës së Komisionit. Ju falënderoj dhe shpresoj që do të kemi bashkëpunim të mirë.

Anton Quni- Përshëndetje për të gjithë dhe ju uroj punë të mbarë për këtë legjislaturë. Nëse i referohemi përvojës së kaluar, jam i bindur që do të kalojmë mirë, pasi kemi qenë si Komision model në raportet e brendshme në funksion të punës në Komision.

Gjithashtu edhe stafi afron mbështetje gjatë punës. Edhe pse disa tema, momente kanë qenë të sikletshme në raport me programet politike, ne kemi shikuar aspektet profesionale në shërbim të qytetarëve.

Zafir Berisha- Përshëndetje për të gjithë, për mua është një rikthim në këtë Komision, pasi edhe më parë kam qenë pjesë e tij. Ky Komision i referohet çështjeve specifike dhe të rëndësishme për vendin.

Duke qenë se në kuadër të Komisionit janë fuzionuar dy fusha, FSK-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme, deri sa në rregullore kanë qenë të ndara, duke qenë se në rregullore ka pak dallime të përgjegjësitë, ata që dinë dhe munden duhet të japin kontribut në këtë Komision.

Gjithashtu më intereson të dijë nga stafi, që ligjet e kaluara në lexim të parë në mandatin kaluar, a do të shkojnë në lexim të dytë, apo si do të procedohet? Pasi vlerësoj që do të ishte mirë t'i kishim këto material, në mënyrë që të jemi të përgatitur.

Qerim Bajrami- Përshëndetje për të gjithë, si anëtar i ri në këtë Komision, nuk kam shumë përvojë ushtarake, por besoj që e jap kontributin tim.

Jam përfaqësues nga komuniteti boshnjak, por në këtë Komision përfaqësoj Grupin Parlamentar 6+.

Besoj do të jemi konstruktivë në procesin e krijimit të ushtrisë dhe të marrim edhe ne pjesën që na takon si komunitete.

Bojan Miliq- Fillimisht përshëndetje për të gjithë, dëshiroj t' i uroj kryetarit zgjedhjen për këtë mandat dhe anëtarëve të tjerë dhe besoj se bashkëpunimi në Komision do të jetë konstruktiv. Unë do të mundohem të jem konstruktiv duke qenë se është hera e parë që jam në këtë Komision të kësaj natyre. Do të kontribuoj në ngritjen time dhe që ligjet që do të vijnë në Komision të shqyrtohen, në mënyrë që si ekip të kemi rezultate të mira për të gjithë qytetarët që jetojnë këtu. Ju faleminderit.

Ganimete Musliu- Përshëndetje për të gjithë deputetët dhe i uroj për mandatin e ri. Gjithashtu falënderoj stafin mbështetës që kanë qenë pjesë e këtij Komisioni në legjislaturën e kaluar. Kam qenë pjesë e këtij Komisioni në legjislaturën kaluar, në këtë mandat shpresoj të kemi bashkëpunim të mirë dhe se puna e këtij Komisioni na bënë të tejkalojmë bindjet partiake dhe shpresoj që ky Komision aktivitetin e tij ta zhvilloj ashtu siç ka funksionuar në mandatin e kaluar. Gjithashtu jemi falënderues për ish- anëtarët e këtij Komisioni dhe shpreh mirënjohjen për udhëheqjen nga ish-kryetari z. Ahmet Isufi, i cili ka qenë transparent dhe konstruktiv gjatë gjithë punës.

Nuredin Ibishi- Përshëndetje për anëtarët e Komisioni, gjithashtu konsideroj se ky Komision mbulon një sektor të rëndësishëm, pasi tashmë ka përfunduar analiza e rishikimit strategjik të Sektorit të Sigurisë, ku duhet shikuar nga aspekti i reformave që duhet bërë dhe transformimin e FSK-së.

Mendoj se duhet t'i përcjellim nga afër të gjitha këto zhvillime, si në aspektin e gjendjes së sigurisë, por edhe rreth strukturës së Policisë së Kosovës, inspektorateve, agjencive dhe FSK-së. Si njohës i rrethanave dhe përcjellës i rrethanave aktuale, do të kontribuoj me mundësitë e mia.

Kryetari- Pra konstatojmë që Komisioni është Funkcional.

Gjithashtu ju prezantoj me stafin mbështetës, z. Nur Çeku, koordinator i Komisionit dhe Zarife Aliu, zyrtare e fushës. Sa i përket organizimit të takimeve të Komisionit, propozoj që të caktojmë një ditë dhe orë të rregullt për takimin e Komisionit. Propozoj ditën e hënë, në orën 11:00.

Ndërsa për materialet që përmendi z. Zafir Berisha, do të mundohemi që sa më shpejt të bëjmë një përmbledhje nga mandati i kaluar, cilat ligje janë miratuar, cilat nuk janë miratuar, çfarë pritet të vijë në Komisione etj.

A jeni dakord që takimet e Komisionit të mbahen të hënë, në orën 11:00.

Ganimete Musliu- Me sa jam në dijeni të gjitha ligjet dhe vendimet që kanë qenë në procedurë ose që kanë kaluar në lexim të parë kthehen nga fillimi.

Kryetari- Çështja është të sigurohen materialet e nevojshme, gjithashtu do të mbajmë një takim të përbashkët me ish-Komisionin, ish-ministrin Agim Çeku dhe ministrinë aktual të Ministrisë së FSK-së, me qëllim të bartjes së dinamikës.

Me që tani janë festat e fund vitit, propozoj që të akordohemi parimisht kur do të mund të takohemi.

Gjithashtu ligji për buxhetin do të vijë në seancë, më 29 dhjetor, në kuadër të këtij buxheti mund të përgatiten amendamente, edhe pse mundësia është e kufizuar.

Kam bërë një propozim për FSK-në, pasi mendoj që është gabim të ndahen një milion e gjysmë për ndërtimin e një poliklinike, ndërkaq barnat esenciale edhe nuk janë siguruar.

Nëse jeni dakord ditën e hënë parimisht e caktojmë si ditë kur do të mbahen takimet e Komisionit.

Zafir Berisha- Me sa jam në dijeni, në këtë të hënë është seanca plenare për shqyrtimin e buxhetit dhe mund të koïncidojë.

Fadil Demaku- Mund të lihen dy variante, të hënë ose të martën. Kësaj radhe mund të lihet të martën, pasi të hënë është seanca.

Kryetari- Të hënë ose të martën ju njoftojmë edhe një herë për takimet e radhës, dhe deri në këtë kohë do t' i merrni materialet që kanë kaluar në leximin e parë dhe që presin të kalojnë në lexim të dytë.

Bazuar në rregulloren e punë së Kuvendit, të gjitha materialet i kthehen Komisionit dhe procedohen nga fillimi.

Nuredin Ibishi- Vetëm desha të shtoj që për mënyrën e komunikimit dhe konfirmimit nga ana e anëtarëve, sa i përket marrjes së materialit dhe ftesave, në mënyrë që të kemi bashkëpunim më të mirë.

Kryetari- Në parim jemi dakorduar me stafin që informimi të bëhet me sms, email dhe viber, si dhe të bëhet konfirmimi për pranimin e materialit.

Bojan Miliq- Është me rëndësi që materialet të pranojmë me kohë, ashtu siç e parasheh rregullorja dhe ligji, që të jemi të gatshëm për çdo takim.

Kryetari- Të gjitha materialet do të jenë në kohë. Prioritet kemi planin e punës për vitin 2015, ku më pas do t'u dorëzohet anëtarëve të Komisionit, ku do të përcaktojmë objektivat, por kjo varet edhe nga ligjet që vijnë nga ekzekutivi.

Gjithashtu, si Komision, duhet të punojmë me organizata ndërkombëtare, që në të kaluarën kanë qenë mbështetëse të procesit, sidomos të Policisë së Kosovës. Gjithashtu në kuadër të mbikëqyrjes kemi edhe emergjencat, zjarrfikësit, pasi gjendja e tyre nuk është e mirë, po ashtu edhe sektori civil i dokumentacionit në kuadër të MPB-së, ku Komisioni ka kompetencë mbikëqyrjen.

Gjithashtu te transformimi i FSK-së në FAK, natyrisht që këto janë marrëveshje politike dhe ne, si Komision, do t'i përkrahim pasi ky proces është i rëndësishëm. Obligimi ynë është të japim mbështetje dhe të votojmë, ndërsa kush është kundër mund të votojë kundër.

Personalisht mendoj që jemi vonuar në këtë aspekt, pasi ky segment duhet të konsiderohet i Kosovës dhe jo i ndonjë grupi politik apo kombësie.

Ky Komision mund të ketë përplasje, por nga ju pres bashkëpunim në mënyrë që të kemi rezultate.

Nëse keni çështje për të ngritur urdhëroni?

Nëse jo, e konsideroj të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj